

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është iniciuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe përmirësimit të dhënies së kontributit të mëtejshëm për zhvillimin e bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, me qëllim luftën kundër krimit.

Marrëveshja përmban detyrim të ndërsjellë për të luftuar krimin në tërësi dhe në mënyrë të veçantë krimin e organizuar dhe financimin e terrorizmit.

Gjithashtu, marrëveshja synon vendosjen e marrëdhënieve mbi baza reciprociteti për parandalimin dhe goditjen e krimit, shkëmbimin e eksperiencave në luftën kundër krimit etj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve për Ministrinë e Brendshme, por është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe implementimi i tij do të mundësojë rritjen e efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese për luftën kundër krimit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj është hartuar mbi bazën dhe nën frymën e respektimit të legjislacionit kombëtar të të dyja shteteve, marrëveshjeve ndërkombëtare të njohura dhe të pranuar nga palët, duke synuar rritjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, financimit të terrorizmit dhe krimeve në tërësi në të gjitha format e shfaqjes së tij, vendosjen e marrëdhënieve mbi baza reciprociteti për parandalimin dhe goditjen e krimit, shkëmbimin e eksperiencave në luftën

kundër krimit, si dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të Policisë së Shtetit nëpërmjet trajnimeve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj propozohet të miratohet në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 100 dhe të nenit 121, të Kushtetutës, i cili në shkronjën “b”, të pikës 1, përcakton se:

“1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj, në rastet kur ato kanë të bëjnë me:

b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;”.

Pra, marrëveshja i nënshtrohet ratifikimit me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi lidhet me të drejtat themelore të njeriut, për sa i përket shkëmbimit të të dhënave personale (shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës), në përputhje me përcaktimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare.

Për sa më sipër, paraqitja për miratim e këtij projektligji bazohet në nenin 100 të Kushtetutës, në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes me Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Projektmarrëveshja përmban detyrim të ndërsjellë për të luftuar krimin në tërësi dhe në mënyrë të veçantë në fushat e poshtëshënuara, që përbëjnë dhe nenin 1, të marrëveshjes.

- Terrorizmi dhe financimi i tij;
- Krimet kundër shtetit;
- Krimi i organizuar transnacional;
- Krimet që lidhen me narkotikët, substancat psikotrope, prekursorët dhe tregtimi i paligjshëm i tyre;
- Krimet financiare dhe ekonomike;
- Krimet e pastrimit të parave;
- Korrupsioni;
- Mashtrimi;
- Mashtrimi dhe falsifikimi i valutës;
- Vjedhja ose kontrabanda e mjeteve të transportit ose tregtia e paligjshme e tyre;
- Vjedhja ose kontrabanda e armëve të zjarrit, municioneve ose lëndëve plasëse, tregtimi i paligjshëm i tyre. Vjedhja ose kontrabanda e materialeve radioaktive, bërthamore, bakteriale, biologjike ose kimike ose tregtimi i paligjshëm i tyre;
- Krimet kundër personave apo pasurisë;
- Trafikimi i qenieve njerëzore;
- Kalimi i paligjshëm i kufijve kombëtarë ose çdo mbështetje për kalim të paligjshëm të tij;
- Trafikimi, vjedhja ose kontrabanda e antikiteve dhe e sendeve me vlerë historike, kulturore ose artistike ose tregtimi i paligjshëm i tyre;
- Krimet kibernetike;
- Vjedhja ose kontrabanda e metaleve të çmuara, sendeve ose gurëve të çmuar ose tregtimi i paligjshëm i tyre;
- Krimet mjedisore.

Në nenin 2 parashikohet se bashkëpunimi, në kuadër të përmbushjes së qëllimit, do të shtrihet dhe në fusha të tjera, konkretisht:

- secila palë do të njoftojë palën tjetër për çdo informacion të disponueshëm për çdo aktivitet kriminal që synon palën tjetër, qoftë i kryer apo i planifikuar, në territorin e njërës palë ose atë të një pale të tretë;
- zbatimi i dorëzimit të kontrolluar ndërmjet palëve, në rastet që kanë të bëjnë me narkotikët, substancat psikotrope dhe prekursorët kimikë;
- kërkimi i personave në kërkim dhe shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave personale të individëve të dyshuar për kryerjen e ndonjë prej krimeve, të përmendura në nenin 1, përfshirë informacionin financiar dhe bankar, të justifikuar;

- shkëmbimi i shpejtë i informacionit për individë, grupe apo organizata terroriste, veçanërisht, informacione në lidhje me strukturën, aktivitetet, burimet e financimit dhe mjetet e komunikimit të tyre;
- vlerësimi i kërcënimeve nga krimet e terrorizmit dhe financimi i terrorizmit, krimet e organizuara, krimet që lidhen me narkotikët dhe substancat psikotrope dhe prekursorët kimikë dhe përditësimi i informacionit lidhur me to për krijimin e mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e krimeve të tilla;
- shkëmbimi i informacionit dhe ekspertizës në lidhje me mbrojtjen e mjeteve të transportit dhe të udhëtarëve;
- shkëmbimi i informacionit dhe ekspertizës në lidhje me çdo mjet dhe teknikë të re të kryerjes së krimeve, si dhe metodat e luftimit të tyre;
- shkëmbimi i ligjeve, rregulloreve dhe publikimeve në lidhje me luftën kundër krimit, të nxjerra nga agjencitë kompetente të palëve;
- shkëmbimi i emrave të personave të dënuar për krime të rënda të kryera ndaj palës tjetër, si dhe emrave të personave të ndaluar, përkohësisht, për krime të rënda të kryera nga shtetas të palës tjetër;
- palët, me marrëveshje të ndërsjellë, mund të bashkëpunojnë në fusha të tjera të sigurisë, me kusht që një bashkëpunim i tillë të jetë në përputhje me qëllimet e kësaj marrëveshjeje.

Në nenin 3 parashikohet mënyra e njoftimit kur një nga palët ndalon një shtetas të palës tjetër për ndonjë nga krimet e parashikuara në këtë marrëveshje, agjencia kompetente e palës që ndalon ose arreston do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur shtetin e personit të ndaluar ose të arrestuar.

Neni 4 parashikon bashkëpunimin në fushën e trajnimit për sigurinë dhe neni 5 parashikon rastet e refuzimit të bashkëpunimit, pjesërisht ose plotësisht.

Në nenin 6 përcaktohen rregullat e ruajtjes së konfidencialitetit, neni 7 parashikon se cili ligj do të aplikohet për secilën palë dhe neni 8 parashikon mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Në nenin 9 sanksionohet se shpenzimet në lidhje me zbatimin e saj do të përballohen nga pala, në territorin e së cilës janë kryer shpenzimet, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe.

Nenet 10 dhe 11 parashikojnë pikat e kontaktit të secilës palë dhe ngritjen e komitetit të përbashkët.

Në nenin 12 parashikohen dispozitat përfundimtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për Republikën e Shqipërisë autoritete kompetente janë Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Marrëveshja ngarkon me përgjegjësi çdo nënshkrues të saj për zbatimin e marrëveshjes. Secila palë do të përballojë shpenzimet e kësaj marrëveshjeje. Kostot financiare, të parashikuara në nenin 9 të marrëveshjes, do të përballohen nga buxheti i programit “Policia e Shtetit”.

KËSHILLI I MINISTRAVE